

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2018

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permiresuar dhe
Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

INTRACOM TELECOM ALBANIA S.A.

Str. "Ibrahim Rugova", "Sky Tower", 3rd floor, Tirana, Albania

tel.: +355 4 2265798-9, +355 4 2265801 | fax:+355 4 2265800 | info@intracom-telecom.al | www.intracom-telecom.al

Bashkangjitur po ju dergojme;

Pasqyra e Pozicionit Financiar / Bilanci më 31 dhjetor 2018

- *Pasqyra e Performances (të ardhurave dhe shpenzimeve) më 31 dhjetor 2018*
- *Pasqyra e ndryshimeve në kapital më 31 dhjetor 2018*
- *Pasqyra e fluksit të parasë më 31 dhjetor 2018*
- *Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare*

Raporti i ekspertit kontabel

Gjendja inventarit të materialeve

Inventari i mjeteve të transportit në pronësi

Kontratat e qirase

Njoftim i transaksioneve vjetore të kontrolluara

Deklarata e Tatimit Fitimit të Vitit 2018

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek)

Bilanci	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Aktivët			
I. Aktivët afatshkurtra			
1. Mjete monetare	4	264,040,577	311,337,942
2. Derivative dhe aktive të mbajtura për tregtim			
3. Inventari		26,962,072	31,638,179
3.1 Apartamente për shitje	6	101,240,162	106,634,016
4. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7	61,202,920	14,401,698
5. Aktive të tjera financiare	5	267,880,219	224,113,540
Totali i aktiveve afatshkurtra (I)		721,325,950	688,125,375
		0	
II. Aktivët afatgjata			
1. Investime financiare afatgjata			
2. Aktive afatgjata materiale	8	6,091,371	7,233,920
3. Aktive afatgjata jomateriale	9	937,866	1,107,353
4. Aktive të tjera afatgjata			
Totali i aktiveve afatgjata (II)		7,029,238	8,341,273
Totali i aktiveve (I + II)		728,355,188	696,466,648
Detyrimet dhe kapitali			
I. Detyrimet afatshkurtra			
1. Derivatet			
2. Huat afatshkurtra		0	0
3. Detyrimet për t'u paguar dhe paratimet	10	75,431,861	41,927,441
4. Grantet dhe të ardhurat e shtyra		105,403,965	0
5. Provizionet afatshkurtra			
6. Detyrime të tjera afatshkurtra			
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		180,835,826	41,927,441
II. Detyrimet afatgjata			
1. Huat afatgjata			
2. Provizionet afatgjata			
3. Grantet dhe të ardhurat e shtyra			0
4. Detyrime të tjera afatgjata		-	
Totali i detyrimeve afatgjata (II)			0
Totali i detyrimeve (I + II)		180,835,526	41,927,441
III. Kapitali			
1. Kapitali aksioner		116,394,000	116,394,000
2. Rezervat statutores dhe ligjore		11,639,400	11,639,400
3. Rezerva të tjera		385,799,495	490,065,490
4. Fitimi (humbja) e vitit		33,686,467	36,440,316
Totali i kapitalit (III)		547,519,362	654,539,206
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I + II + III)		728,355,188	696,466,648

Bilanci duhet të interpretohet së bashku me shenimet shpjeguese në faqet 6-14.

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 u përgatitën nga **Enkelejda KELLICI**, u aprovuan nga **Georgios BLEKAS** më 29.03.2019 dhe u nënshkrua si më poshtë;

Enkelejda KELLICI
Drejtoreshë Financiare

Georgios BLEKAS
Drejtor i Përgjithshëm
INTRACOM TELECOM ALBANIA S.A.
Ibrahim Rugova Str.,
"Sky Tower", 3 rd floor, Tirana, Albania
Tel: +355 (4) 2268811, Fax: +355 (4) 2268812

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Pasqyra e Performances (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek)

	Shenime	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2018	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2017
1. Te ardhura nga shitja neto		429,015,543	451,401,019
2. Te ardhura nga sherbime publike te komunikimeve elektrnike	11	1,715,000	1,785,000
3. Te ardhura dhe shpenzime te tjera neto			
4. Materialet e konsumuara	12	(213,720,694)	(252,459,529)
5. Kosto e punes:	13	(114,943,577)	(115,008,489)
- Pagat e personelit		(104,582,590.00)	(104,533,655.00)
- Sigurimet shoqerore dhe shendetsore		(10,360,987.00)	(10,474,834.00)
6. Amortizimet dhe zhvleresimet		(3,757,547)	(3,508,190)
- AQT	8/9	(2,091,755)	(2,022,364)
- Inventari Imet	3.3/6	(1,665,792)	(1,485,826)
7. Shpenzime te tjera	14	(40,222,710)	(37,932,873)
8. Totali i shpenzimeve (4-7)		(372,644,528)	(408,909,080)
9. Fitimi (humbja) nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)		58,086,016	44,276,939
10. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara			
11. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesmarrjet			
12. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare:	15	(17,642,440)	(523,626)
12.1. Te ardhura nga interesat, neto			
12.2. Te shpenzime nga interesat, neto			
12.3. Te ardhura (shpenzime) nga kurset e kembimit, neto		(17,642,440)	(523,626)
12. 4. Te ardhura (shpenzime) te tjera financiare, neto			
13. Totali i te ardhurave (shpenzimeve) financiare,neto (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)		(17,642,440)	(523,626)
14. Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)		40,443,575	43,753,313
15. Tatim fitimi	16	(6,757,108)	(7,312,997)
16. Fitimi (humbja) e vitit (14-15)		33,686,467	36,440,316
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		0	0

Bilanci duhet te interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6-14.

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 u pergatiten nga **Enkelejda KELLICI**, u aprovuan nga **Georgios BLEKAS** me 29.03.2019 dhe u nenshkrua si me poshte;

Enkelejda KELLICI
Drejtoresh Financa



Georgios BLEKAS
Drejtor i Pergjithshem

INTRACOM TELECOM ALBANIA S.A.
Ibrahim Rugova Str.,
"Sky Tower", 3 rd floor, Tirana, Albania.
Tel: +355 (4) 2265801, Fax: +355 (4) 2265802

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare (metoda indirekte)

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	33,686,467	36,440,316
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,091,755	2,022,364
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	14,904,344	114,742,577
Rënie/(rritje) në inventarë	10,069,961	35,701,447
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	33,436,138	(41,982,507)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	94,188,665	146,924,197
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit		
a. Para të përdorura për blerjen e filialeve (netuar me shumën e mjeteve monetare pjesë e aktiveve neto të blera)		
b. Para të arkëtuara nga shitja e filialeve (netuar me shumën e mjeteve monetare pjesë e aktiveve neto të shitura)		
c. Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(779,720)	(2,466,507)
d. Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
e. Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		(614,530)
f. Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
g. Dividentë të arkëtuara		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e investimit	(779,720)	(3,081,037)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit		
a. Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
b. Rregullime të vete të kaluara		
c. Hua të arkëtuara		
d. Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		
e. Riblerje e aksioneve të veta		
f. Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
g. Pagesa e huave		
h. Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
i. Interes i paguar		
j. Dividendë të paguar (personi fizik terheq)	(140,706,311)	(54,198,878)
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e financimit	(140,706,311)	(54,198,878)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve mon	(47,297,366)	89,644,282
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	311,337,942	221,693,660
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	264,040,576	311,337,942

Pasqyrat duhet të interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese në faqet 6-14.

INTRACOM TELECOM ALBANIA

□ Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Intracom Telecom Albania sh.a është themeluar në vitin 2001. Kapitali I shoqërisë është 100% I huaj. Aktiviteti kryesor I shoqërisë është Nderimi I Antenave të telefonisë celulare për Operatorët kryesorë "Vodafone Albania" sh.a dhe "AMC". Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim, Shoqëria ka nënshkruar Kontrata Shërbimi kryesisht me AMC e Vodafone në funksion të përmirësimit të teknologjisë në fushën e telefonisë celulare. Numri i punonjësve më 31.12.2017 është 51 dhe më 31.12.2018 është 51 .

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në zbatim të Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) NR 2 të përmirësuar si dhe Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushtat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtëme janë aplikuar për periudhën që fillon më 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare të paraqitura në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.10

3.2 Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhës së raportuar nuk ka patur investime ne kapital apo instrumenta borxhi të përdorura gjatë aktivitetit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimë të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshitësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi financiar, dhe mospagesa apo kundravajtje në pagesa (mbi 360 ditë vonesë) konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huaatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale. Aksionet e preferuara të detyrueshmë me të drejtë riblerjeje klasifikohen si detyrime.

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3.3 Aktive afat-gjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten në "Ndërtim në proces" dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afat-gjate materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëparshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afat-gjatë në periudhën aktuale janë si më poshtë:

Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Aktivitetet e patrupëzuara	Lineare	15%
Pajisje dhe programe IT	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të gjitha aktivitetet e tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Inventarin e Imet është llogaritur 15% e vlerës.

3.4 Zhvlerësimi

(i) Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivitetin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

(ii) Aktivitet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnje e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove perkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit.

4. Arkat dhe bankat

Arkat dhe bankat më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë përbërë si me poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari rrjedhëse		
Lek	40,466,362	34,692,057
Usd	-	-
Euro	50,326,435	82,757,287
	90,792,796	117,449,344
Te tjera	172,788,386	193,657,386
Arka		
Lek	459,395	231,213
	459,395	231,213
	264,040,577	311,337,942

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

8. Aktive afat-gjata materiale

Aktivitet afat-gjata materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë përbërë si më poshtë:

	Makineri Pajisje	Mobilje dhe orendi	Kompjuteri dhe pajisje informatike	Totali
Kosto				
Më 1 janar 2017	2,146,197	8,576,387	12,435,630	23,158,215
Shtesa	80,404		2,386,103	2,466,507
Pakesime				0
Më 1 janar 2018	2,226,601	8,576,387	14,821,733	25,624,722
Shtesa		195,432	491,446	686,879
Pakesime				0
Më 31 dhjetor 2018	2,226,601	8,771,820	15,313,180	26,311,601
Amortizimi i akumuluar				
Më 1 janar 2017	(1,961,128)	(7,798,061)	(6,981,593)	(16,740,782)
Amortizimi per pakesime				
Shuma për vitin	48,083	142,068	1,459,869	1,650,020
Më 1 janar 2018	(2,009,211)	(7,940,129)	(8,441,462)	(18,390,802)
Amortizimi per pakesime				0
Shuma për vitin	39,285	140,800	1,649,342	1,829,427
Më 31 dhjetor 2018	(2,048,496)	(8,080,929)	(10,090,804)	(20,220,229)
Vlera e mbetur				
Më 31 dhjetor 2018	178,105	690,891	5,222,376	6,091,372

9. Aktive afat-gjata jomateriale

Aktivitet afat-gjata materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë përbërë si më poshtë:

	Konc, Patenta Licenca, etj	Totali
Kosto		
Më 1 janar 2017	3,789,012	3,789,012
Shtesa	614,530	614,530
Më 1 janar 2018	4,403,542	4,403,542
Shtesa	92,841	92,841
Më 31 dhjetor 2018	4,496,383	4,496,383
Amortizimi i akumuluar		
Më 1 janar 2017	2,923,845	2,923,845
Shuma për vitin	372,344	372,344
Më 1 janar 2018	3,296,189	3,296,189
Shuma për vitin	262,328	262,328
Më 31 dhjetor 2018	3,558,517	3,558,517
	0	
Vlera e mbetur		
Më 31 dhjetor 2018	937,866	937,866

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

10. Huatë dhe parapagime afat-shkurtra

Huatë dhe parapagimet më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë përbërë si me poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Furnitorë	45,845,394	34,256,792
Detyrime tatimore per Sig shoq. Shend	1,413,979	1,346,389
Detyrime tatimore per TAP-in	2,800,949	2,542,093
Te pagueshme ndaj punonjesve	426,203	426,183
TVSH për tu paguar	24,882,292	3,577,523
Të tjera	63,044	36,319
Te ardhura te shtyra	105,403,965	(257,858)
TOTALI	180,835,826	41,927,441

11. Shitjet neto

Shitjet neto përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shitje neto	429,015,543	451,401,019
Te ardhura nga sherbime publike te komunikimeve elektrnike	1,715,000	1,785,000
TOTAL	430,730,543	453,186,019

12. Materiale te konsumuara

Materialet e konsumuara përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenz karb, projekt, materiale	201,977,772	242,513,073
Shpenzime Transporti dhe udhëtimi	11,742,921	9,946,456
TOTALI	213,720,694	252,459,529

13. Kostot e personelit

Kostot e personelit përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Paga	104,582,590	104,533,655
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shendetësore	10,360,987	10,474,834
TOTALI	114,943,577	115,008,489

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

5. Aktive të tjera financiare afat-shkurtra

Aktivët afat-shkurtra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë	266,025,288	216,881,986
Debitore, Kreditore te tjere	474,369	1,158,677
Tatim mbi fitimin	1,380,563	6,072,878
<i>Gjendje e mbartur</i>	6,072,881	8,944,234
<i>Tatim Fitim Periudhes</i>	(6,757,108)	(7,312,997)
<i>Kompensime</i>	-	-
<i>Tatim fitimi paraprak i paguar</i>	2,064,790	4,441,641
Te tjera tatimore		
TOTALI	267,880,220	224,113,540

6. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është i përbërë nga :

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Lendet e para dhe materiale ndihmese	21,657,980	26,361,696
Inventari imet	5,304,092	5,276,483
TOTALI	26,962,072	31,638,179

	31 dhjetor 2018
Apartamente per shitje	101,240,162
TOTALI	101,240,162

	Inventari imet	Totali
Më 1 janar 2018	10,330,589	10,330,589
Shtesa	1,693,402	1,693,402
Pakesime	0	0
Më 31 dhjetor 2018	12,023,990	12,023,990
Mbartje	5,054,106	5,054,106
Shuma për vitin	1,665,792	1,665,792
Amortizimi per pakesime	0	0
Më 31 dhjetor 2018	6,719,898	6,719,898
	0	0
Vlera e mbetur		0
Më 31 dhjetor 2018	5,304,092	5,304,092

7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shpenz te periudha te ardhme	6,040,848	5,227,430
Parapagime		
Parapagime per qera	3,028,901	2,437,759
Paradhenie 3 % per ceshtje gjygesore	-	-
Paradhenie te tjera	52,133,171	6,736,509
Shpenzime të shtyra	-	-
TOTALI	61,202,920	14,401,698

INTRACOM TELECOM ALBANIA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

14. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për shërbime konsulence	617,195	612,241
Shpenzime qiraje	20,728,668	21,602,153
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	862,477	919,042
Shpenzime në lidhje me personelin	1,475,349	1,649,846
Shpenzime postare, telekomunikacioni dhe komisione bankare	1,619,351	2,236,464
Certifikime / Trajnime profesionale te stafit	2,444,216	2,906,074
Shpenzime transporti	-	-
Shpenzime përfaqësimi	1,127,299	1,301,240
Shpenzime të tjera	3,094,984	3,220,291
Mirëmbajtje dhe riparime	812,442	1,195,420
Sponsorizime	2,793,624	1,904,524
Shpenzime konsumi për zyrë	478,106	362,140
Shpenzime reklame dhe promocionale	32,500	187,755
Penalitete, gjoba dhe dëmshpërblime	-	-
Tatime, të tjera rakordime	4,136,499	(164,316)
TOTALI	40,222,710	37,932,873

15. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare neto përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit Te ardhurat nga interesat	
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit Humbje të parrealizuara nga kursi i këmbimit	(17,642,440)
TOTALI	(17,642,440)

16. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar ne legjislacionin shqipëtar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2018.

Deklaratat tatimore dorëzohen cdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregulloret shqipëtare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	6,757,108	7,312,997
TOTALI	6,757,108	7,312,997


INTRACOM TELECOM ALBANIA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Rikoncilimi i normës efektive të tatimit

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
	%	%
Fitimi/ humbja e periudhës para tatimit	100.00%	100.00%
Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde	15.00%	15.00%
Zëra shpenzimesh të panjohura		
Djeta	2,054,000	1,707,000
Transport personeli Taxi		33,637
Shpenz per zbatim vendimi gjygesor		
Diff shpenz		
Te tjera	2,549,812	3,259,363
TOTALI	4,603,512	5,000,000


Enkelejd KELLICI
Drejtorë Finance


Georgios BLEKAS
Drejtor i Pergjithshem

INTRACOM TELECOM
INTRACOM TELECOM ALBANIA S.A.
Ibrahim Rugova Str.,
"Sky Tower", 3 rd floor, Tirana, Albania.
Tel: +355 (4) 2265801, Fax: +355 (4) 2265800
V.A.T. No.: K12006001H